

Kushtet e Veçanta për Sigurimin e Rreziqeve të Zmadhuara - DL031008

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

1. Kushtet e Veçanta për Sigurimin e Rreziqeve të Zmadhuara, në vazhdim Kushtet e Veçanta, zbatohen me rastin e kontraktimit të sigurimit të jetës, si dhe për Sigurimin Shtesë nga Aksidentet Personale.
2. Kushtet e Veçanta zbatohen në kontratat për sigurim, në rast të rreziqeve të zmadhuara, pa marrë parasysh se a është në konsiderim Oferta për sigurimin e jetës apo kërkesa për riaktivizimin e policës.
3. Me Kushtet e Veçanta definojnë:
 - a. sëmundjet tek të cilat është përjashtuar mundësia e nënshkrimit të kontratës për sigurimin e jetës
 - b. rastet në të cilat Siguruesi mund ta shtyj pranimin e ofertës për kohë të caktuar
 - c. sëmundjet për të cilat pranimi në sigurim kushtëzohet me shikim paraprak të mjekut
 - d. përqindja e ngritjes së primit të sigurimit të sigurimet e personave nga aksidentet
 - e. ngritja e moshës së Personit të Siguruar në sigurim
 - f. rrethanat tjera të rëndësishme me rastin e definimit të kontratës me rrezik të zmadhuar

Neni 2

Zbatimi i Këtyre Kushteve

1. Me zbatimin e Kushteve të Veçanta mund të sigurohen personat të cilët kanë aftësi pune të zvogëluar për shkak të sëmundjeve, mangësive apo mungesave trupore të cilët po të mos i kishin këto sëmundje apo mangësi do të ishin siguruar pa aplikimin e këtyre Kushteve të Veçanta.
2. Nëse ndonjë formë e rrezikut të zmadhuar nuk është paraparë me këto Kushte të Veçanta, Siguruesi do të kryej vlerësimin e rrezikut të dhënë sipas analogjisë për rreziqet e ngjashme apo të përafërta.

Neni 3

Shkalla e Rrezikut të Zmadhuar për Shkak të Sëmundjes

1. Në rast të sëmundjeve të rënda të cilat paraqesin rreziqe të theksuara të zmadhuara, Siguruesi do të refuzoj nënshkrimin e kontratës për sigurimin e jetës dhe atë në rastet në vazhdim:
 - a. Sëmundjet e zemrës dhe sistemit kardiovaskular, gjakut dhe palcës së eshtrave:
 - i. Agranulocitoza (numër i zvogëluar i granulociteve në gjakun periferik)
 - ii. Aneurizma e arterieve trunore dhe arterieve të mëdha të sistemit qarkullues (të lindura apo të fituara si pasojë e zgjerimit patologjik);
 - iii. Angina pectoris (sëmundje iskemike e zemrës)
 - iv. Aortiti (sëmundje e aortës) me etiologji specifike apo jo-specifike (Luesi-sifilizi, sëmundja e Takayasuoves)
 - v. Apoplexia (Insulti cerebrovaskular)
 - vi. Arrytymia absoluta (çrregullim i ritmit të zemrës - aritmi absolute)
 - vii. Arterisclerosis cerebri et generalisata (arterioskleroza e vazave trunore të gjakut apo e gjeneralizuar-edhe në sistemin qarkullues)
 - viii. Leukemia dhe sëmundjet tjera malinje të organeve hematopoetike-palcës kockore;
 - ix. Miodegeneratio cordis apo lloje të tjera të kardiomiopative, miokarditiseve, endokarditiseve apo perikarditisit
 - x. Morbus Raynaud (sëmundje e arteriolave e shoqëruar me spazmë dhe zbehje të lëkurës në periferi)
 - xi. Nephroangiosclerosis (degjenerim progresiv i vazave të gjakut të veshkave)
 - b. Sëmundjet shpirtërore dhe sëmundjet tjera të sistemit nervor dhe dëgjimit:
 - i. Abusus droge (narkomania)
 - ii. Psikoza afektive (depresioni, mania, psikoza manjako-depresive)
 - iii. Alkoolizmi i konstatuar në mënyrë spitalore me pasqyrë delirante apo kronik (me dëmtime trupore apo mentale)
 - iv. Morbus Cushingov (tumor i përparmë i hipofizës)
 - v. Demencia (preseniliteti, sëmundja e v. Alzheimerit apo Pickova, demencia vaskulare, demencia e Parkinsonit, sëmundja e Huntingovit, demencioni postraumatik etj)

- vi. Epilepsia (Epilepsia gjenerale)
- vii. Sëmundjet demijelinizuse të sistemit qendror nervor (skleroza multiple dhe sëmundjet e ngjashme)
- viii. Retardimi mental i shkallës së mesme dhe të rëndë (deabiliteti i rëndë, imbecilizmi dhe idioti)
- ix. Paralysis progressiva (sëmundja e Luesi - sifilisit të sistemit nervor)
- x. Paralysis agitans (rastet e rënda të sëmundjes së Parkinsonit)
- xi. Psychosis (shizofrenija, psikozat paranoike, gjendjet tjera psikotike si dhe rastet e rënda të psikopatisë)
- xii. Syringomyelia (kavitete degjenerative të mbushura me lëng në palcën kurrizore)
- xiii. Tabes dorsalis (Sëmundja e Luesit-sifilizit e rrënjëve të pasme të palcës kurrizore)
- xiv. Tentament suicidi (tentim vetëvrasje i verifikuar)
- c. Sëmundjet Endokrine:
 - i. Morbus Addison (insuficienca adrenokortikale)
 - ii. Diabetes insipidus (si shkaktar qendror apo periferik)
 - iii. Diabetes juvenilis (diabeti rinor para moshës 20 vjeçare)
 - iv. Krenenizmi (ngecja trupore dhe shpirtërore më së shpeshti si pasojë e disfunkcionit të gjëndrës tiroide)
 - v. Mixoedema (gjendje të rënda të hipotireozës)
 - vi. Morbus Simmonds apo llojet tjera të hipopituitarizmit (zvogëlimi apo ndërprerja totale e lirimit të hormoneve të hipofizës si pasojë e hipofunkcionit endokrin të gjëndrës)
- d. Sëmundjet tjera të organeve:
 - i. AIDS (sindromi imunodeficiar i fituar)
 - ii. Cirrhosis hepatis (cirroza e mëlçisë)
 - iii. Colitis ulcerosa (Sëmundje kronike ndezëse e zorrës së trashë me etiologji të pa njohur)
 - iv. Cor pulmonale (Zemra mushkërore)
 - v. Fibrothorax bilateral (bllokim patologjik i indit lidhor i hapësirës, pleurali i dyanshëm apo bilateral)
 - vi. Hydronephrosis bilateralis (Hidronefroz bilaterale)
 - vii. Lupus erythematodes
 - viii. Tumoret malinj të përfshira edhe gjendjet pas ndërhyrjeve kirurgjike
 - ix. Morbus Paget dhe sëmundjet tjera sistemike të skeletit
 - x. Pemphigus (dermatite buloze të etiologjive të ndryshme)
 - xi. Echinokoku policistik
 - xii. Scleroderma (skleroza sistematike progresive)
 - xiii. Uraemia (dobësim i dyanshëm bilateral i veshkave)
 - xiv. Varices oesophagei (zgjerim i venave të ezofagut)
 - xv. Xeroderma pigmentosa (sëmundje e rrallë vdekjeprurëse e lëkurës)
- 2. Personat e sëmurë nga sëmundjet akute apo sëmundjeve për të cilat parashihet shërim operativ, sipas rregullave, nuk mund të nënshkruajnë apo ta riaktivizojnë kontratën për sigurim deri sa shërimi të përfundoj, respektivisht deri sa nuk vërtetohet shkalla përfundimtare e invaliditetit të përhershëm
- 3. Shtyrja e pranimit të ofertës apo kërkesës për riaktivizim zbatohet veçanërisht në rastet e ekzistimit të sëmundjeve në vazhdim:
 - a. Hyperthrophia prostatae (zgjerim patologjik i prostatës)
 - b. Incontinentia urinae (pamundësia e mbajtjes së urinës)
 - c. Leptospirosis (Leptospiroz-sëmundje infektive e përcjellë me dëmtim të organeve të brendshme)
 - d. Nephrolithiasis (Kalkuloza në veshkë)
 - e. Stricture urethrae (Ngushtim i uretrës)
 - f. Tuberculosis ossium (Tuberkuloz aktiv i kockave)
 - g. Sëmundjet që kanë nevojë për ndërhyrje kirurgjike
- 4. Siguruesi mund ta shtyj pranimin e ofertës apo kërkesës për riaktivizim të kontratës për sigurimin e jetës për një kohë të caktuar, në rast se personi ka qenë i helmuar me metale të rënda (zink, plumb, zhivë, etj.) dhe materie tjera të dëmshme dhe kimikale të cilat kërkojnë një ekzaminim të funksioneve të organeve të brendshme.
- 5. Periudha kohore gjatë së cilës Siguruesi mund ta shtyj pranimin e ofertës apo kërkesës për riaktivizim të kontratës së sigurimit është një vit duke llogaritur edhe ditën kur oferta i është dorëzuar
- 6. Siguruesi mund ta pranojë ofertën për nënshkrim, respektivisht ta aprovoj kërkesën për riaktivizim të kontratës për sigurim në rast të ekzistimit të sëmundjeve të caktuara vetëm me mendim të mjekut censor.
- 7. Sëmundjet nga pika 6 e këtij Neni janë:
 - a. Sëmundjet e zemrës dhe sistemit kardiovaskular, gjakut dhe organeve hematopoetike (palcës kockore):

- i. Anaemia aplastica, haemolitica (Anemia për shkak të prodhimit jo të mjaftueshëm të rruazave të kuqe të gjakut)
- ii. Cor decompensatum (Zemra e dekompensuar)
- iii. Haemophilia (gjakderdhje të shpeshta dhe rezistuese për shkak të çrregullimit të koagulimit të gjakut të trashëguara)
- iv. Tachycardia (ves i zemrës)
- b. Sëmundjet shpirtërore dhe sëmundjet tjera të sistemit nervor dhe dëgjimit
 - i. Dystrophia musculorum (dobësim muskular i trashëguar)
 - ii. Epilepsia (Kapje e papritur, zënie, rënie, sulm, krizë)
 - iii. Hydrocephalus (zgjerim patologjik i hapësirës së trurit i mbushur me lëng)
 - iv. Insuficiencia mentale (në kufi të koeficientit të inteligjencës, debilitet i lehtë)
 - v. Morbus Parkinson (sëmundje ekstrapiramidale, raste tipike)
 - vi. Psychoneurosis nuclearis (neuroza e bërthamave)
 - vii. Psychosindroma organicum (dobësi mentale si pasojë organike)
 - viii. Surdomutitas (të qenë i shurdhët)
- c. Sëmundjet tjera të organeve:
 - i. Arthritis chronica deformans (deformim kronik i nyjeve si pasojë e ndezjes)
 - ii. Tumoret Beninj
 - iii. Fistula bronhijale
 - iv. Ehinoku i mëlçisë apo i mushkërive
 - v. Haepatitis chronica (Hepatit kronik i mëlçisë)
 - vi. Tuberculosis enteridis (Tuberkulozi i zorrëve)
 - vii. Tuberculosis pulmonum (Tuberkulozi i mushkërive)
 - viii. Tuberculosis renis (Tuberkulozi i veshkave)
- 8. Sëmundjet tek të cilat me rastin e nënshkrimit të kontratës për sigurimin e jetës mosha e hyrjes në sigurim ngritët për 15 vite, dhe primi për sigurim të personave nga aksidentet ngritët për 100%:
 - a. Sëmundjet e zemrës dhe sistemit kardiovaskular
 - i. Insufficiencia aortae (Insuficiencia e aortës)
 - ii. Insufficiencia mitralis (Insuficiencia mitrale)
 - iii. Hypertensio arterialis (shtypja e gjakut në mes 180/115 mm Hg)
 - iv. Hypertonia essentialis (shtypja e rritur e gjakut 170-180/115 mm Hg)
 - v. Gjendja pas infarkt të zemrës
 - vi. Morbus Buerger (ngushtim i kapilarëve të v. gjakut të ekstremiteteve të poshtme)
 - b. Sëmundjet shpirtërore dhe sëmundjet tjera të sistemit nervor dhe dëgjimit
 - i. Anthracosis (sëmundje e mushkërive si pasojë e pluhurit të qymyrit)
 - ii. Bronchiectasiae (zgjerim cilindrik apo në formë të kesëve i bronkeve)
 - iii. Fibrothorax unilateralis (bllokim patologjik i indit lidhor i hapësirës pleurali i njëanshem) si dhe ndryshime tjera restriktive të mushkërive me zvogëlim të volumit të mushkërive mbi 50 %
 - iv. Hernia diaphragmalis (Herni diafragmale)
 - v. Hydronephrosis unilateralis (hydronefroze e njëres veshkë)
 - vi. Morbus Bechterew (spodiliti ankiloz)
 - vii. Polypos recti (Polip i zorrës së trashë)
 - viii. Silicosis (sëmundje e mushkërive si pasojë e pluhurit të mëndafshhtë)
 - ix. Ulcus jejuni (ulcerë e zorrëve të holla)
 - x. Morbus Meniere (Sëmundja e Menierit)
 - xi. Amblyopia (dobësim i të pamurit mbi 50%)
- 9. Sëmundjet tek të cilat me rastin e nënshkrimit të kontratës për sigurimin e jetës mosha e hyrjes në sigurim ngritët për 10 vite, dhe primi për sigurim të personave nga aksidentet ngritët për 75%:
 - a. Sëmundjet e zemrës dhe sistemit kardiovaskular, gjakut dhe organeve hematopoetike (palcës kockore):
 - i. Anaemia pernicioza (Anemia megaloblaste si pasojë e mungesës së vitaminës B12)
 - ii. Claudicatio intermitens (dhembje dhe gërrqe periodike të ekstremiteteve për shkak të çrregullimit të qarkullimit)
 - iii. Hypertensio arterialis (160-170/110 mm Hg)
 - iv. Ulcus cruris (Zgjerim i venave të ekstremiteteve të poshtme me ndryshime trofike në lëkurë)

- b. Sëmundjet shpirtërore dhe sëmundjet tjera të sistemit nervor dhe dëgjimit:
 - i. Anacusis bilateralis (Shurdhim i dyanshëm)
 - ii. Glaucoma (ngritje e shtypjes të syve)
 - c. Sëmundjet tjera të organeve:
 - i. Arthritis reumatoides (reumatizmi i vërtetuar i nyjeve)
 - ii. Bronchitis chronica (Bronhit kronik)
 - iii. Diabetes adultum (sëmundja e sheqerit e paraqitur për herë të parë para moshës 20 vjeçare)
 - iv. Diathesis urica (sëmundja mbretërore apo ndezje e nyjeve - artritis)
 - v. Divertikulum (xhepi i traktit gastrointestinal)
 - vi. Emphysema pulmonum (emfizema e mushkërive)
 - vii. Morbus Basedow (Hipertireoza me egzoftalmus dhe strum)
 - viii. Osteomyelitis recidivans (pezmatim i kockave i përsëritur)
 - ix. Të ngritura në hapësirën e abdomenit (pas ndezjes apo intervenimeve kirurgjike)
 - x. Psoriasis (Psorjaza)
 - xi. Status post nephrectomia (Gjendje pas heqjes së njërës veshkë)
10. Sëmundjet tek të cilat me rastin e nënshkrimit të kontratës për sigurimin e jetës mosha e hyrjes në sigurim ngritët për 5 vite, dhe primi për sigurim të personave nga aksidentet ngritët për 50%:
- a. Sëmundjet e zemrës dhe sistemit kardiovaskular
 - i. Hypertonia essentialis (shtypja e gjakut e rritur 150-160/105 mm Hg)
 - ii. Varices cruris (zgjerim i venave pa ndryshime trofike të lëkurës)
 - b. Sëmundjet tjera të organeve
 - i. Sëmundjet e mushkërive e përcjellur me zvogëlim të kapacitetit vital nën 3000 ccm për meshkuj dhe 2000 ccm për femra
 - ii. Ulcus ventriculi seu duodeni (ulcera në lukth apo në zorrën dymbëdhjetë gishtore)
 - iii. Hernia umbilicalis seu inguinalis (Herni e umbilikusit apo inguinale)
 - iv. Hyperthyreosis (funksioni i shtuar i gjëndrës tiroide)
 - v. Hypothyreosis (pa shenja për retardim mental)
 - vi. Status post splenectomiam (gjendje pas largimit të shpretkës - lienit)

Neni 4

Shkalla e Rrezikut të Zmadhuar për Shkak Humbjes së Aftësisë për Punë

1. Për personat aftësia punuese e të cilëve është zvogëluar në përputhshmëri me tabelën e invaliditetit, primi për sigurimin shtesë aksidentet personale ngritët sipas tabelës në vazhdim:

Aftësia e përgjithshme punuese e zvogëluar për	Primi Rritet
50 - 74%	50%
75 - 99%	75%
100%	100%

2. Për personat që në momentin e kontraktimit të sigurimit, pesha trupore e të siguruarit devijon prej peshës ideale trupore për më shumë se 35 kilogram, primi ngritët për 50%. Me peshë ideale trupore nënkuptojmë peshën e shprehur në kilogram e që merret prej gjatësisë së të siguruarit të shprehur në centimetra e prej së cilës zbriten 100.

Neni 5

Dispozitat Përfundimtare

1. Të gjitha ato çështje të cilat nuk janë të rregulluara me këto Kushte të Veçanta zbatohen dispozitat e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës të Siguruesit, dhe ligjet me të cilat rregullohet kjo materie.